KONTRATË BINJAKËZIMI

# Përkrahje për Statistikat

# Kosovë

# RAPORT MBI MISIONIN

**Sistemi i Teknologjisë Informative dhe Diseminimi**
**Përmirësimi i Diseminimit – Komunikimi i drejtpërdrejtë me përdoruesit**

Komponenti 4
**Aktiviteti 4.8.**


Misioni i realizuar nga
Sanne Vestergaard Nielsen, Statistikat e Danimarkës
Lone Birgitte Schlüter, Statistikat e Danimarkës


1-5 Dhjetor 2014

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| | | |

***IPA 2012***

*Sanne Vestergaard Nielsen*
*Statistics Denmark*
*Sejrøgade 11*
*DK-2100 Copenhagen Ø*
*Denmark*
*Tel: +45 39 17 36 29*
*Email: svn@dst.dk*

*Lone Birgitte Schlüter*
*Statistics Denmark*
*Sejrøgade 11*
*DK-2100 Copenhagen Ø*
*Denmark*
*Tel: +45 39 17 30 04*
*Email: lon@dst.dk*

# Përmbajtja

1. Komente të përgjithshme ..... 4
2. Vlerësimi dhe rezultatet ..... 4
3. Konkluzionet dhe rekomandimet ..... 4
Aneksi 1. Termat e Referencës ..... 6
Aneksi 2. Personat e takuar ..... 10
Aneksi 3. Fotografi nga aktiviteti në universitet ..... 11
Aneksi 4. Prezantimi i paraqitur në universitet ..... 12

# Lista e shkurtesave

| | |
|---|---|
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| TeR | Termat e Referencës |
| STD | Statistikat e Danimarkës |

# 1. Komente të përgjithshme

Ky mision u realizua në kuadër të Projektit të Binjakëzimit „Përkrahje për Statistikat". Ishte misioni i parë kushtuar Komunikimit të Drejtpërdrejtë me Përdoruesit, në kuadër të komponentit 4.8 të projektit. Misioni kishte për qëllim të definojë një plan strategjik, si bazë për implementimin e mëtejmë të projektit në këtë fushë.

Objektivat kryesore të misionit ishin:

Të përgatitet një kurs trajnimi për studentët e Universitetit të Prishtinës.
Në këtë kurs u paraqitën:

- Burimet e statistikave evropiane
- Statistikat në dispozicion në Kosovë
- Si të kuptohen statistikat / Si MOS të përdoren

Konsulentët dëshirojnë të falenderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës (SD).

# 2. Vlerësimi dhe rezultatet

Kursi u mbajt në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës. Ishin të pranishëm rreth 200 studentë, si dhe Profesoresha Rahmije Mustafa. Prezantimi paraqitet në aneksin 3. Pjesën mbi ASK-në e prezantoi Hazbije Qeriqi, Zyrtare për Komunikim në ASK. Pjesën mbi Eurostat-in e prezantoi znj. Lone Schlüter, Shefe e Divizionit në Statistikat e Danimarkës, dhe znj. Sanne Nielsen, Shefe e Divizionit në Statistikat e Danimarkës, bëri një prezantim të shkurtër mbi Binjakëzimin.

Gjatë prezantimit kishte pak probleme me internetin, që i shpërqëndroi pak studentët. Por, në përgjithësi, ishte një aktivitet i mirë dhe më pas znj. Hazbije Qeriqi në ASK ka marrë shumë kërkesa nga studentët, duke treguar interesim për kursin.

Profesoresha Rahmije Mustafa tha se ishte e kënaqur me prezantimin dhe mendon që ky do të duhej të ishte një aktivitet i rregullt vjetor për studentët e rinj, duke siguruar që të gjithë studentët të marrin njohuritë elementare për gjetjen e statistikave deskriptive.

Prezantimi do t'u dërgohet edhe studentëve, bashkë me linkun e ASK-së dhe të Eurostat-it.

Stafi i ASK-së ishte shumë i përkushtuar ndaj këtij misioni, edhe pse ngarkesa e madhe e punës ua pamundësonte pjesëmarrjen gjatë gjithë kohës në takim. Gjatë përgatitjes së kursit për studentët, ekspertet e vendeve anëtare folën edhe për përvojat e Statistikave të Danimarkës në komunikimin e drejtpërdrejtë me përdoruesit, si dhe si të plotësohen nevojat e përdoruesve.

# 3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Rekomandohet të vazhdohet me zhvillimin e kurseve dhe marrëdhënieve të mira me Universitetin.

Duhet pasur në konsideratë çështjet në vijim:

- Mbajtja e kontakteve me Universitetin. Kjo është një mënyrë e rëndësishme për të mesuar vendimmarrësit e ardhshëm si të gjejnë dhe përdorin statistikat zyrtare.
- Identifikimi i interesave dhe temave të studentëve, gjë që ndihmon në fokusimin e kurseve relevante që plotësojnë nevojat e tyre aktuale për informacione. Përdorimi i shembujve aktualë për ta do ta rrisë relevancën e kursit.
- Kurt ë bëhet public PX-web nga ASK-ja, do të ishte e dobishme për studentët të mbahej një kurs mbi funksionalitetet e PX-web.
- Zgjerimi i kursit edhe në universitetet private.
- Sigurimi i një zgjidhjeje rezervë për të mos qenë tërësisht i\e varur nga interneti gjatë prezantimit.
- Në këtë kontekst, mund të përdoren slajde me imazhe të marra nga interneti në rast se lidhja me internet nuk është e qëndrueshme.
- Bëjeni thjeshtë. Përmbajtja e kursit është shumë komplekse. Më mire të ketë më shumë studentë që kuptojnë një kurs më të thjeshtë se sa pak studentë, që kuptojnë një kurs të ndërlikuar.
- Konsideroni zgjerimin e komunkimit të drejtpërdrejtë edhe me grupe të tjera, si Parlamentin, institucionet qeveritare etj.

.

| **Veprimi** | **Afati kohor** | **Personi përgjegjës** |
|---|---|---|
| Shembuj të kurseve të ngjashme në Statistikat e Danimarkës, të përkthehen dhe dërgohen znj. Hazbije Qeriqi për inspirim | 20 Dhjetor, 2014 | Lone Schlüter, DST |
| Folderi i Bankës Statistikore të Statistikave të Danimarkës ti dërgohet znj. Hazbije Qeriqi për inspirim | 31 Janar, 2014 | Sanne Nielsen, DST |

# Aneksi 1. Termat e Referencës

## Projekti i Binjakëzimit i BE-së
**KS12 IB ST 01**
Përkrahje për Statistikat

## Termat e Referencës:

**Komponenti 4: Sistemi i Teknologjisë Informative dhe Diseminimi**
**Aktiviteti 4.8: Përmirësimi i Diseminimit – Komunikimi i drejtpërdrejtë me përdoruesit**

**Orari:**
**TeR –të gatshëm:** **17 Nëntor 2014**
**Fillimi /përfundimi i aktivitetit:** **1-5 Dhjetor 2014**
**Raportimi:** **12 Dhjetor 2014**

**Rezultati obligativ i komponentit:**

| Rezultati obligativ | Intervenimi logjik | Standardet | Burimet e informacionit | Supozimet |
|---|---|---|---|---|
| **Activiteti 4.2** | **Zhvillimi i sistemit të TI-së dhe diseminimit** | • Faqja e internetit e ASK-së dhe përdorimi i saj, të përmirsuar deri në tremujorin e 8-të të projektit<br>• Databaza e diseminimit, e instaluar dhe e hapur për publikun, deri në tremujorin e 7-të të projektit | • Raportet tremujore të projektit<br>• Raportet e misioneve | • Kapacitet i mjaftueshëm absorbimi<br>• Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim<br>• Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes te misioneve Termat e referencës, te perpiluara me kohë, që paraqesin ne detaje detyrat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura, pjesëmarrësit ne aktivitet dhe agjendën |

**Tema / qëllimi i aktivitetit: aktiviteti 4.8**
Zhvillimi dhe mbajtja e një kursi si mjet për përmirësimin e komunikimit të drejtpërdrejtë me përdoruesit mes ASK-së dhe përdoruesve

**Rezultati i pritur nga aktiviteti 4.8**
Mbajtja e një kursi trajnimi për studentët e Universitetit të Prishtinës.
Kursi do të mbulojë keto tema:

- Burimet e statistikave evropiane
- Burimet e statistikave në Kosovë
- Si të kuptohen statistikat / Si MOS të përdoren statistikat

**Aktiviteti 4.8 do të sigurojë keto rezultate**:

Gjatë këtij misioni, ASK-ja do të paraqesë aktivitetet e veta në lidhje me komunikimin me përdoruesit kryesorë dhe vendosjen e kontakteve me përdorues potencial, si studentët. ASK-ja do të informojë ekspertet e vendeve anëtare për gjendjen aktuale në fushën e komunikimit të drejtpërdrejtë me përdoruesit, si kurset, takimet me përdoruesit etj. Do të përgatitet dhe mbahet një kurs për studentët e ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, nga stafi i ASK-së në bashkëpunim me ekspertët e vendeve anëtare.

Ekspertet e vendeve anëtare do të prezantojnë para stafit të ASK-së politikën e diseminimit në Statistikat e Danimarkës dhe iniciativat e komunikimit të drejtpërdrejtë me përdoruesit. Ekspertet e vendeve anëtare dhe të ASK-së do të bëjnë një matricë të praktikave të ASK-së dhe të Statistikave të Danimarkës në fushën e diseminimit/komunikimit me përdoruesit. Kjo matricë do të përdoret si mjet për caktimin e prioriteteve dhe fushave të veprimit në këtë fushë gjatë kohëzgjatjes së projektit.

Në mënyrë që të kenë mundësi të ofrojnë sugjerime për përmirësime në komunikimin e drejtpërdrejtë me përdoruesit, ekspertet kërkuan nga stafi i ASK-së t'I informojnë për çfarëdo takimi/kontakti të rregullt me përdoruesit.

Gjithashtu, u përgatit dhe u mbajt kursi mbi burimet statistikore në Universitetin e Prishtinës, në kohëzgjatje prej 1-1.5 orë.

Transferi i njohurive se si t'u paraqiten informatat mbi fushat statistikore përdoruesve të jashtëm.

Sugjerime për kurse/trajnime të tjera nga ASK-ja me qëllim ngritjen e vetëdijes për statistikat e prodhuara nga ASK-ja.

**Stafi i ASK-së:**

1. Znj. Hazbije Qeriqi, Përgjegjëse për Komunikim dhe Informim, ASK, hazbije.qeriqi@rks-gov.net
2. Znj. Drita Sylejmani, Zyrtare për Diseminim, ASK, drita.sylejmani@rks-gov.net
3. Znj. Shqipe Gashi, Zyrtare për Diseminim, ASK shqipe.gashi@rks-gov.net
4. Z. Burim Limolli, Shef i Ti-së, ASK burim.limolli@rks-gov.net

**Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:**
Udhëheqës i Projektit ne ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombetare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

**Ekspertet e vendeve anëtare:**
Znj. Lone Birgitte Schlüter, Shefe e Divizionit, Statistikat e Danimarkës, lon@dst.dk
Znj. Sanne Vestergaard Nielsen, Shefe e Divizionit, Statistikat e Danimarkës, svn@dst.dk

**Stafi i Projektit të Binjakëzimit:**
Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk
Znj. Nora Zogaj, RTA asistente, nzogaj@yahoo.com

**Historiku për aktivitetin**

Në përgjithësi, aktivitetet në komponentin 4 do të adresojnë çështjet në vijim:

- Përmirësimin e diseminimit perms web-it për statistika të caktuara, përfshirë
- Përmirësimin e web faqes së ASK-së, për ta bërë atë më të lehtë për ta përdorur dhe mjet më fleksibil diseminimi;
- Zhvillimin e udhëzuesve për dizajnimin e tabelave dhe grafikave, po ashtu të aplikohen për diseminimin në web;
- Zhvillimin e databazës së diseminimit, përfshirë më shumë metadata të kompletuara, që mbulojnë aspekte të ndryshme lidhur me cilësinë e të dhënave;
- Përmirësimin e komunikimit të drejtpërdrejtë me përdoruesit
- Zbatimin e Kodit të Praktikës për Diseminimin

**Aktivitet që duhet të ndërmerren si parapërgatitje për misionin:**
Lista e dokumentave të bashkangjitura

- Raporti i Vlerësimit Global të Adaptuar (AGA)
- Programi i statistikave zyrtare 2013 -2017
- Plani i Zhvillimit Strategjik 2009- 2013
- Raportet e misioneve të Projektit të Binjakëzimit, komponenti 4 (mund të gjenden në dst.dk/Kosovo)

## Aneksi 1.1. Programi - Dhjetor 2014

| Dita | Vendi | Koha | Aktiviteti |
|---|---|---|---|
| | | | |
| **1** | ASK | 10:00 | Hyrje në këtë pjesë të komponentit 4 |
| | | 10:15 | ASK informon ekspertet për gjendjen aktuale në këtë fushë |
| | | 11:00 | Pushim për kafe |
| | | 11:15 | Ekspertet informojnë ASK për aktivitetet e Statistikave të Danimarkës në këtë fushë |
| | | 11:45 | Dreka |
| | | 13:15 | Ekspertet informojnë ASK për iniciativat e komunikimit të drejtpërdrejtë me përdoruesit në Statistikat e Danimarkës |
| | | 14:30 | Pushim për kafe |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | 15:00 – 16:00 | Përgatitja e programin për ditët në vijim |
| | | | |
| **2** | ASK | 09:00-16:00 | Përgatitja e kursit për studentët në Universitetin e Prishtinës, ndarja e punës dhe materialet |
| **3** | ASK | 09:00-16:00 | Përgatitja e kursit për studentët në Universitetin e Prishtinës, ndarja e punës dhe materialet |
| **4** | ASK | 09:00-16:00 | Mbajtja e kursit në Universitetin e Prishtinës<br>Vlerësimi i kursit<br>Shkrimi i raportit |
| **5** | ASK | 09:00-12:00 | Shkrimi i raportit<br>Takim mes ekperteve, udhëheqësit të komponentit, udhëheqësit të projektit në ASK dhe RTA |
| | | | |

# Aneksi 2. Personat e takuar

ASK:

Znj. Hazbije Qeriqi, Përgjegjëse për Komunikim dhe Informim, ASK, hazbije.qeriqi@rks-gov.net
Znj. Drita Sylejmani, Zyrtare për Diseminim, ASK, drita.sylejmani@rks-gov.net
Znj. Shqipe Gashi, Zyrtare për Diseminim, ASK shqipe.gashi@rks-gov.net
Z. Burim Limolli, Shef i Ti-së, ASK burim.limolli@rks-gov.net

Takimi në ASK:
Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

**Stafi i Projektit të Binjakëzimit:**
Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk
Znj. Nora Zogaj, RTA asistente, nzogaj@yahoo.com

Universiteti i Prishtinës:
Profesor Rahmije Mustafa
Prodekane Florentina Xhelili

# Aneksi 3. Fotografi nga aktiviteti në Universitet









# Aneksi 4. Prezantimi i paraqitur në universitet




1




2




3




4




5




6

## Monitorimi i shfrytëzuesve në ueb-faqen e ASK-së



7

## Vizualizimi i të dhënave



8

## Qasje online në te dhënat e agreguara te regjistrimit të popullsisë.

Sistemi DaWinçi është mjaft fleksibël dhe i lehtë për t'u përdorur. Përmes tij, përdoruesve u mundësohet të shfletojnë tabela, pa ndonjë rrugë të paracaktuar qasjeje, duke zgjedhur lirshëm llojin e të dhënave dhe nivelin e detajeve. Ata, po ashtu, mund ta ulin a ngritin këtë nivel detajesh sipas dëshirës së tyre. Përdoruesi, gjithashtu mund t'u qaset edhe të dhënave të tjera të disponueshme për një nivel të dhënë detajesh, me vetëm një klikim.



9

## PX-Web

PC-Aksi është përzgjedhur si mjet kryesor i cili ka një shtrirje të gjerë në shumë vende të botës dhe ka origjinën nga vendet nordike. Stafi i IT KAS "është njohur me këtë teknologji që ata kanë ndjekur trajnime në këtë fushë.



10

## Bashkëpunimi me Eurostat

Agjencia e Statistikave të Kosovës bashkëpunon ngushtë me Eurostat, zyra statistikore e Bashkimit Evropian. Përveç dërgimit të të dhënave tona kombëtare statistikore në Eurostat ne gjithashtu ndihmojë përdoruesit tanë për të pasur qasje në Statistikat Evropiane dhe të sigurojmë mbështetje përdoruesve në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze. Në vazhdim është një përshkrim i shkurtër i shërbimeve që ofron Eurostat



11

## Eurostat statistics include

- EU15: 1995
  AT, BE, DE, DK, EL, ES, FI, FR, GB, IE, IT, LU, NL, PT, SE
- EU25: 2004
  + CY, CZ, EE, HU, LT, LV, MT, PL, SI, SK
- EU27: 2007
  + RO, BG
- EU28: 2013
  + HR

- Candidate countries: Albania, Montenegro, Iceland, the former Yugoslav Republic of Macedonia, Serbia and Turkey
- Potential candidates: Bosnia and Herzegovina, **Kosovo** (under UN Security Council Resolution 1244/99)
- Other countries: Norway, Schwitzerland, USA, Japan, China etc.

12

## Eurostat website – front page




13

## Eurostat - database

Nine themes

- General and regional statistics
- Economy and finance
- Population and social conditions
- Industry, trade and services
- Agriculture and fisheries
- International trade and services
- Agriculture and fisheries
- International trade
- Transport
- Environment and energy
- Science and technology

14

## Eurostat themes




15

## Eurostat – Theme (example): National accounts (including GDP)




16

## Eurostat – main tables




17

## Eurostat – main tables




18




19




20




21




22




23




24